



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMANIZIMIT

Nr.2256/1 prot.

Tiranë më 05.01.2023

Lënda: Mendim mbi projektligjin “Për llogarinë e pagesave me shërbime bazike”

MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit”) ka administruar shkresën tuaj nr. 23901 prot., datë 28.12.2022, me anë të së cilës dërgohet për mendim projektligji “Për llogarinë e pagesave me shërbime bazike” si dhe dokumentat shoqërues.

Nga shqyrtimi i projektligjit “Për llogarinë e pagesave me shërbime bazike”, Zyra e Komisionerit vlerëson se, në tërësi, ky projektligj zbaton standardet e mbrojtjes së të dhënave personale, si një akt që synon të jetë i harmonizuar me legjislacionin evropian në këtë fushë, megjithatë, me qëllim reflektimin e frymës së Rregullores së Përgjithshme Evropiane për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (GDPR), duke marrë parasysh që legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale është në fazë përafrimi me acquis communautaire të Bashkimit Evropian në këtë fushë, në vijim do të vlerësojmë marrjen në konsideratë nga ana juaj të sugjerimeve të mëposhtme si:

- Pas pikës 3, të nenit 9, të projektligjit të shtohet një pikë me këtë përmbajtje : “Bankat kanë detyrim të informojnë konsumatorët, pa pagesë, në një formë koncize, transparente, të kuptueshme dhe lehtësisht të aksesueshme, mbi të drejtat dhe detyrimet që gëzojnë, në zbatim të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.”
- Në pikën 3, të nenit 14, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime: pas togfjalëshit “...të miratimit paraprak...” të shtohet: “...mjaftueshmërisë së të dhënave, integritetit dhe konfidencialitetit, me kusht që të garantohet niveli i mbrojtjes së të dhënave personale sipas legjislacionit në fuqi”.

Së fundi, Zyra e Komisionerit sugjeron gjithashtu përfshirjen në këtë projektligj të një neni specifik për mbrojtjen dhe përpunimin e të dhënave personale, (*marrë për analogji edhe nenin 87 të Ligjit nr. 55/2020 “Për shërbimet e pagesave” si një ligj që vetë ky projektligj i referohet*) me këtë përmbajtje:

“Përpunimi i të dhënave personale, për qëllime të këtij ligji, kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Subjektet sipas fushës së zbatimit të këtij ligji aksesojnë, përpunojnë dhe mbajnë të dhëna personale të nevojshme për hapjen dhe përdorimin e llogarisë së pagesave me shërbime bazike, me pëlqimin e shprehur qartazi të subjektit të të dhënave.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi